



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Ekonomisë shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

| | |
|-----------------------------------|---|
| Titulli i pozitës së punës | Zyrtar i Lartë i Sistemit të Ngrohjes dhe Gazit Natyror |
| Klasa e pozitës | Profesional 1 |
| Koeficienti/Paga | 8 |
| Nr. i kërkuar | 1 |
| Data e njoftimit | 02/03/2022 |
| Afati për aplikim | 17/03/2022 - 31/03/2022 |
| Institucioni | Ministria e Ekonomisë |
| Departamenti | Departamenti i Energjisë |
| Divizioni | |
| Vendi i punës | Divizioni i Sistemeve të Energjisë |
| Nr. i Referencës | RN00008470 |
| Kodi | RPC0002261 |



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin përgatitë planet e punës së Divizionit të Sistemeve të Energjisë, përfshirë objektivat e punës, aktivitetet, formën e zbatimit dhe rezultatet e pritshme të realizimit me fokus sistemin e ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror;
2. Monitoron sistemet e ngrohjes qendrore nga pikëpamja e sigurisë teknike dhe të furnizimit me energji përkatëse të sistemeve dhe raporton në baza periodike dhe sipas kërkesave;
3. Monitoron zbatimin e politikave që lidhen me sistemin e ngrohjes qendrore dhe atë të gazit natyror;
4. Përgatitë dhe propozon politika dhe masa lidhur me zhvillimin e sistemeve të ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror;
5. Propozon dhe merr pjesë në hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve dhe rregullave lidhur me sistemet e ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror;
6. Përgatitë analiza dhe/ose propozon studime në fushën e ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror dhe propozon politika dhe masa të bazuara mbi rezultatet e analizave dhe studimeve;
7. Merr pjesë në forume, takime dhe grupe pune ekspertësh, qoftë brenda qoftë në organizata ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë, për çështje që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, raporton dhe përgatitë propozim qëndrime zyrtare;
8. Përgatitë komentet dhe propozon qëndrimet zyrtare lidhur me planet zhvillimore të sistemeve të ngrohjes qendrore dhe të gazit natyror.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare drejtimi i Makinerisë me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale brenda sektorit të energjisë



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 07/04/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Prishtinë, 20/04/2022, ora 10, Ministria e Ekonomisë Adresa: Ndertesa ish- Toskana /Rr. Nëna Terezë,

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të gjuhës Angleze

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

